



Newsletter, KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.9 Shtator 2019

Index:

Aktivitetet 2

Aktivitetet 3

Deklaratë 5

KMD në media 6

HAPET ZYRA E RE E KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI NË FIER



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda, së bashku me autoritetet lokale të Fierit përuruan çeljen e zyrës rajonale të KMD në Fier, pranë sporteleve të ADISA-s, ku qytetarët e 3 qarqeve Fier, Vlorë e Lushnje do të kenë mundësinë të informohen, ankohen dhe të gjejnë të drejtën e tyre, nëse ndjehen të diskriminuar.

Krahas Komisionierit Dr. Gajda, Prefektit të Qarkut Fier, Baki Bala, në ceremoni mori pjesë dhe zv/Kryetarja e Bashkisë Fier, Enkelejda Peshkëpia që vlerësuan përzgjedhjen strategjike për të promovuar të drejtat e njeriut dhe luftuar diskriminimin në këtë aks të rëndësishëm dhe të mbipopulluar.

Komisioneri Dr. Gajda theksoi rëndësinë e hapjes së zyrës në një rajon të madh siç është Fieri. Prania e saj do të jetë një vlerë e shtuar për komunitetin për adresimin e problematikave të shkeljes së të drejtave dhe luftës së anti-Diskriminimit. Komisioneri përshëndeti bashkëpunimin me qendrën ADISA dhe falenderoi

“Ecuria dhe të rejat më të fundit nga institucionet në kuadër të negociatave të anëtarësimit nga muaji Mars 2019”



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda mori pjesë në takimin e radhës të Këshillit Kombëtar i Integrimit Evropian. Takimi kishte si tematika kryesore: “Ecurinë dhe të rejat më të fundit nga institucionet në kuadër të negociatave të anëtarësimit nga muaji Mars 2019” si dhe “Progresin e realizuar nga institucionet e pavarura për adresimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian në raportin e vitit 2019 për Shqipërinë sidhe nënkomitetit BE-Shqipëri për Drejtësi, Liri dhe Siguri”.

Gjatë fjalës së tij Komisioneri Dr. Gajda Robert Gajda, theksoi se problem ngelej adresimi i rekomandimeve, nga institucionet publike. Ai shtoi se ishin bërë hapa pozitive përse i përket vëmendjes së gjykatave rreth trajtimit të çështjeve të diskriminimit. Ai vlerësoi si pozitiv faktin e rritjes së kapaciteteve të komisionerit ku tashmë ka dhe

3 zyra rajonale për të qenë më afër qytetarëve. Ai informoi se ky institucion kishte hartuar propozimet për ndryshimin e ligjit për mosdiskriminin dhe pas organizimit të konsultimit me shoqërinë civile do t’ia përcillte këto propozime, kuvendit

“Fëmijët dhe reklamat në transmetimet audiovizive”

Stafi i zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në tryezën e diskutimit “Fëmijët dhe reklamat në transmetimet audiovizive”, të organizuar nga Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA). Diskutimi u përqendrua te koordinimi i institucioneve në evidentimin e rasteve të shkeljes së Kodit të Transmetimit si dhe mundësinë e organizimit të fushatave të informimit dhe ndërgjegjësimit me redaksitë audiovizive por edhe me vetë prindërit dhe komunitetin e fëmijëve. Të pranishëm në këtë aktivitet ishin deputetë, përfaqësues të grupit të deputetëve “Miq të Fëmijëve”, nga OSHMA-të, organizatat jo qeveritare që kanë në fokus të punës së tyre liritë dhe të drejtat e fëmijëve, nga institucionet publike, ekspertë të fushës, etj.



Mos ofrim i shërbimit të barabartë me tjerët për shkak të vendbanimit, KMD nis çështjen



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda u njoh me kronikën e Top Channel për problematikën e shkollës në fshatin Plan i Bardhë në Bashkinë Klos, ku 15 fëmijë janë në kushte të pamundura të zhvillojnë procesin mësimor.

Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi do të nisë një hetim kryesisht (*ex officio*), për mos ofrim të shërbimit të barabartë me tjerët për shkak të vendbanimit. Hetimi dhe inspektimi i KMD do të përfshijë të gjithë institucionet qendrore e vendore që kanë tagër ligjor për mbarëvajtjen e procesit mësimor.

Për Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi çdo dallim, përjashtim, kufizim apo parapëlqim, pavarësisht nga shkak, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së

Shqipërisë, nga aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga legjislacioni në fuqi - përbën Diskriminim.

KMD Korçë në workshopin për gjuhën e shenjave

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Gjuhës së Shenjave, Qendra Rajonale Rinore Korçë do të zhvillojë një workshop të emërtuar "Sign Language Rights for All" ku ishin të ftuar përfaqësues të institucioneve publike lokale, medias, shoqërisë civile, bizneseve etj.

Diskutimi u fokusua në përfshirjen e palëve në procesin e integritit social të të rinjve, që nuk dëgjojnë dhe nuk flasin në Qarkun e Korçë. Përfaqësuesja e zyrës së KMD në Korçë, Eva Tare, mbajti një fjalë përshëndetëse dhe ftoi të pranishmit të njihen me rolin dhe funksionimin e institucionit që lufton diskriminimin dhe promovon barazinë.



Komisioneri Gajda në konferencën e nivelit të lartë për 25 vjetorin e ECRI



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda mori pjesë në konferencën e nivelit të lartë për 25 vjetorin e **ECRI** (Komisioni European kundër Racizmit dhe Intolerancës), ku në axhendë është nevoja për një përpjekje të re në luftën kundër Racizmit dhe intolerancës në shoqëritë tona.

Promovimi i barazisë dhe luftimi i racizmit dhe intolerancës janë thelbësore për të ardhmen e Evropës. Përpjekjet tashmë të bëra drejt një barazie më të madhe kanë përmirësuar kushtet e jetës së shumë evropianëve, kanë nxitur shoqëri më gjithëpërfshirëse dhe kanë kontribuar në ruajtjen e stabilitetit, paqes dhe sigurisë në Evropë. Më herët Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda mori pjesë në Grupin e punës së **EQUINET**, mbi standartet dhe projektet e institucioneve të barazisë, që po mbahet në Francë.



KMD i tërheq vëmendjen ligjvënësit Murrizi mbi përdorimin e etikës



Nisur nga publikimi në media i disa shprehjeve që i atribuohet nën/Kryetarit të Kuvendit, z. Myslym Murrizi, në lidhje me përdorimin e gjuhës së urrejtjes përçmuese dhe denigruese kundrejt komunitetit rom, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi fton deputetin që të qartësojë qëndrimin e tij, mbi këtë shqetësim.

Përdorimi i termave që çenojnë dinjitetin e njeriut dhe për më shumë nga persona publikë që kanë rezonancë në media, duke ndikuar në sjellje, mënyra mendimi dhe nxitjen e stereotipeve negative është në kundërshtim me aktivitetin dhe përpjekjet e shumë aktorëve insitucionalë kombëtarë e ndërkombëtare, si dhe organizatave jo qeveritare që mbrojnë të drejtat njerëzore për të luftuar diskriminimin dhe promovuar barazinë.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nxit Kuvendin e Shqipërisë të aktivizojë të gjithë mekanizmat institucionalë në dispozicion për ruajtjen e etikës së zyrtarëve të lartë

KMD tryezë diskutimi mbi amendimet e ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Diskutim për propozimet e ndryshimit të ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi nga aktorët kryesorë shoqërore që operojnë në fushën e të drejtave.







Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Kreu i KMD:

Z. Robert Gajda

Komisioner për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është institucion i pavarur i Republikës së Shqipërisë. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. Ai mbështetet nga Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), e cila ka personelin dhe pajisjet e nevojshme për të mbështetur Komisionerin në përmbushjen e detyrave të ngarkuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010.

Për informacione të mëtejshme mbi aktivitetet:
www.kmd.al

Zyra qendrore e KMD

Rr: Rruga e Durrësit (Ish Ministria e Mjedisit)
Tirana, Albania
Zip Code: 1001
E-mail: info@kmd.al
Tel:
Komisioneri: + 355 4 243 1077
Ankesa: + 355 4 243 1078

Zyra rajonale:

Shkodër: Pranë Bashkisë Shkodër, Rr.13 Dhjetori, Nr.1
Zip Code: 4001
Tel: + 355 4 243 1078

Korçë: Pranë Bashkisë Korçë Rr:28 Nentori Nr.1
Zip Code: 7001
Tel: + 355 4 243 1078